



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I EDUKIMIT FIZIK DHE SPORTIT**

**RREGULLORE E PRANIMIT TË STUDENTËVE NË PROGRAMIN E STUDIMIT
“BACHELOR” NË EDUKIM FIZIK DHE SPORTE PËR VITIN AKADEMIK 2021–2022**

1. Të drejtën për të konkurruar e gëzojnë të gjithë nxënësit që janë diplomuar në arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe në arsimin e mesëm profesional sportiv ose jo sportiv, të cilët kanë përfunduar konform rregullores së MAS, detyrime të Maturës Shtetërore në vitin akademik 2020 – 2021.
2. Mbështetur në VKM Nr. 46dt. 27.01.2021, kanë të drejtë të regjistrohen për të konkurruar të gjithë kandidatët që kanë përfunduar nivelin e arsimit të mesëm dhe sipas pikes 3 të kësaj VKM-je”**Përrjashtohen nga detyrimi i plotësimit të kriterit të notës mesatare** kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare, me karakter profesional, **kandidatët që aplikojnë për t’u pranuar në programet e studimeve në fushën e artit dhe të sportit**, si dhe kandidatët me origjinë nga Republika e Kosovës, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci”.
3. Data e konkurrimit si dhe kuota e pranimit, përcaktohen nga Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani”.
4. Rregulloren e konkurrimit, Normat e pranimit, në programin e studimit "Bachelor" në edukim fizik dhe sporte si dhe Skedën Shëndetësore Individuale, të interesuarit mund ta gjejnë në faqen zyrtare të Universitetit të Elbasanit “A.Xhuvani”, www.uniel.edu.al. Gjithashtu një kopje do e tërheqin në sekretarinë e Fakultetit të Shkencave të Edukimit, në momentin e regjistrimit për konkurrim. Bashkëngjitur do të gjeni skedën e kontrollit shëndetësor dhe datën e caktuar për fillimin e regjistrimit për konkurrim, si dhe datën e zhvillimit të konkursit.
5. Konkuruesit që rezultojnë me probleme të shëndetit, humbasin të drejtën e përfshirjes në konkurrim.
6. Njoftimi për datën, orën dhe vendin e organizimit të konkurrimit, shpallet dy javë para datës së konkurrimit. Njoftimi shpallet në median vizive e të shkruar. Ju mund ta kërkonti atë edhe në adresën e internetit të UE, www.uniel.edu.al
7. Konkuruesit të paraqiten në konkurrim me uniformë sportive.

8. Dokumentat e vlefshme për regjistrim janë:
- Dokument personal identifikimi me fotografi.(Kartë identiteti,ose Pasaporte dhe fotokopje e saj).
 - Skeda shëndetësore e dhënë nga institucioni,e cila vërteton gjendjen shëndetësore të konkurruesit në përballimin e sforcimeve fizike,e plotësuar nga mjekë të specialitetit në rrethin ku i interesuari banon.
 - Dy fotografi.
 - Mandat arkëtimi i tarifës së regjistrimit.
9. Konkurruesi përfiton 60% të pikëve nga konkurrimi sportiv dhe 40% të pikëve nga rezultati i maturës shtetërore.
10. Rezultati shumë i mirë vetëm në një disiplinë sportive ndikon, por jo domosdoshmërisht vendos për suksesin e konkurruesit.
11. Numri maksimal i pikëve në konkursin praktik është 70 pike:
- Atletikë 18 pikë (6 pikë vrapimi 100 m, 6 pikë vrapimi 800 m dhe 6 pikë kërcimi nga vendi.
 - Gjymnastikë 17 pikë (9 pikë akrobaci dhe 8 pikë kërcim kaluçi)
 - Basketboll 18 pikë (9 pikë cirkuidi dhe 9 pikë gjuajtje të lira)
 - Volejbolll 17 pikë (9 pikë shërbimet dhe 9 pikë pasimet)
12. **Konkurruesi duhet te grumbulloje minimumi 15 pikë** për tu kualifikuar në konkursin praktik.
13. Sasia e pikëve të grumbulluara nga konkurruesi në 4 disiplinat sportive: Atletikë, Gjymnastikë, Volejbolll, Basketboll, si rregull mblidhen me pikët e përftuara nga matura shtetërore. Shuma e këtyre pikëve do të përbëjë rezultatin përfundimtar të pikëve që grumbullon çdo konkurrues.

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

DEKANI

Doc. dr. Edmond BIÇOKU

Prof.as.dr.Elisabeta OSMANAJ